



22 tetor 2015

## **KOMUNIKATË/SQARIM PËR OPINION NË LIDHJE ME LËSHIMIN ME QIRA AFATSHKURTËRA DHE VENDOSJEN NËN ADMINISTRIM TË ASETETEVE TË NDËRMARRJEVE SHOQËRORE**

Prishtinë – Agjencia Kosovare e Privatizimit njofton opinionin publik se të gjitha kontratat e qirave afat shkurtër të aseteve të ndërmarrjeve shoqërore janë nënshkruar konform ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme të AKP-së.

Agjencia Kosovare e Privatizimit, duke i parë disa shkrime të pasakta lidhur me qiradhëniet afat shkurtra se gjoja AKP ka lëshuar me qira asete të ndërmarrjeve shoqërore në kundërshtim me procedurat ligjore dëshiron të sqaroj opinionin se AKP vepron në harmoni të plotë me ligjin dhe rregulloret e saj të derivuara nga ligji i AKP-së.

Që nga aprovimi në Gusht 2014 dhe Nëntor 2014 i vendimeve dhe rregulloreve për vendosjen nën administrim ligjor të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, janë shpallur gjithsej 22 tenderë publik për qiradhënie afat shkurtër për 271 asete të NSH-ve.

Të gjitha kontratat e qirasë që ka lidhur Agjencia me palë të ndryshme për asete të ndërmarrjeve shoqërore në likuidim janë bazuar në Ligjin e AKP-së/Shtojca e Ligjit për Likuidim si dhe në Rregulloret që përcaktojnë procedurat e dhënies me qira të këtyre aseteve.

Për asetet në pronësi të NSH-ve të cilat janë vendosur në likuidim nga Bordi i Drejtorëve të Agjencisë, të gjitha kompetencat e organeve menaxhuese dhe mbikëqyrëse të Ndërmarrjeve Shoqërore në likuidim për administrimin e tyre kanë kaluar tek Autoriteti i Likuidimit (AL) sipas nenit 9 të ligjit të AKP-së, përfshirë edhe qiradhënien, ashtu siç parashihet në nenin 28.1 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Sipas nenit 3.7.1. të Udhëzuesit për Likuidim i aprovuar nga Bordi i Drejtorëve në Shtator 2011, Autoritetet e Likuidimit janë të autorizuar të vazhdojnë kontratat e qirasë ose dhënien me qira të cilësdo pronë të Ndërmarrjeve Shoqërore në likuidim.

Opinionin publik njoftohet se vetëm në periudhën 11 mujore janë inkasuar 2.8 milionë euro nga qiradhënia e aseteve apo 63% sa tërë inkasimi i qirasë (4.4 mil euro) që është realizuar për 12 vitet e mëparshme, përveç edhe 4.5 milion tjera që ishin inkasuar përmes marrëveshjeve mes Agjencisë dhe organizatave ndërkombëtare.

Raportet e detajuara për vendosjen nën administrim të këtyre aseteve dhe raportet financiare për të hyrat nga qirasë do t'i dorëzohen Bordit të Drejtorëve dhe Kuvendit të Kosovës.

Agjencia është zotuar se në të ardhmen asnjë shitje nuk do të ndodhë pa u liruar aseti nga uzurpatorët, duke mundësuar kështu rritje të numrit të të interesuarve për blerjen e këtyre aseteve dhe rrjedhimisht rritjes së çmimit të shitjeve.

### **FUND**